

Literary Evolution of Murat Isaku's Lyrics

MSc. Arlind Farizi, Ph.Dc.

Faculty of Philology, Department of Albanian Language and Literature
State University of Tetova, Str. Ilindenska n.n, Tetova, Republic of Macedonia
E-mails: arlindfarizi@gmail.com, arlind.farizi@unite.edu.mk

Received: 30 January 2013; **Revised:** 10 February 2013; **Accepted:** 18 February 2013

Abstract: Back in the sixties of the 20th century, when in the heart of Phenomenology was developed the theory of reception of Hans Robert Jauss³² and it was promoted the notion of Alterity (otherness)³³. According to this viewpoint the phenomenon of "literary evolution" was seen as a change, or permanent transformation of literary awareness. Literary consciousness is relative to what was found also the answer to the question why literary works that follow are not neither better nor worse from the previous ones, but are different. Books do not change, but readers do. Thus, in the science of literature these literary works were disused due to unwanted connotations, not only the biological term "evolution" and the economic term "development" but also the social term "revolution" and instead of them, in the post-modern period began to be used terms, such as: "transformation", "innovative process", "dynamics", "change". With this parantheses we have accessed in one of the main problems of life and functioning of literary art of the word. In the poetries of Murat Isaku "Literary Evolution" is implied the transformation, change, the aesthetic evolution of the poetry from the first collection "Zani i Malit" (1960) (The Mountain Echo) within the system of the certain poetry and how it changes despite time conventions up to the last collection of poetries "M'i këpusin kokrrat e frymës (2007)." (They're plucking out my few deep breaths)

Keywords: lyrics, reidentification, transformation, literary evolution, gratitude, Murat Isaku.

Evoluta Letrare

Krijimtarinë e Murat Isaku në poezi profesori/kritiku letrar Ali Aliu e ndanë në disa faza;

- *Lashtësia e fisit, dhe rropatjet dramatike të atij fisi për të ekzistuar gjatë shekujve,*

- *Revolta dhe përbuzja e padrejtësive dhe të këqijave,*

- *Ngrohtësia dhe apasionimi ndaj së mirë së bukurës,*

- *Besimi dhe shpresa e përhershme,*

- *Bota e ndezur intime dhe ndjenja e vetmisë, e braktisjes dhe fajësisë për shkak të pamundësisë për të ndrequr botën.*

Këto faza ruajnë të fshehur mëvetësinë, sa të koncepcioneve të tij poetike aq edhe atë të stilit të kërkimit të tij filozofik. Ky pozicionim vlerash, zgjedhesh strategjike të përfshirjes dhe përjashtimit, të identitetit dhe alteritetit (shih Paul Ricoeur). Mirëpo, të lexuarit e poezisë së tij ofron mundësinë e hetimit të origjinalitetit të menduarit të tij. Përmbledhja me poezi, e para e Murat Isakut, "Zani i Malit" (1960) tregon rrugëtimin e tij rinjohjes të vetvetes si poet dhe pavetëdijshtëm jep projektin e ndërtimit të *Teorisë së rinjohjes* (pranimit, mirënjohjes). Kjo lidhet me termi "reconnaissance", që e merr në shqyrtim Ricoeur, e cila në frëngjisht ka tri

³² Hans Robert Jaussit - "Horizonti i pritjes", teorizuar nga Jaus, thotë se vepra kur shfaqet vlerësohet dhe interpretohet, por nuk përcakton kuptimin përfundimtar të saj.

³³ Ricoeur, Paul, *Oneself as Another*, translated by Kathleen Blamey (Chicago: The University of Chicago Press, 1992) p. 21.

domethënie kryesore; Rinjohje, Pranim dhe Mirënjohje. Një hulumtim i tillë për poezinë e Murat Isakut ngacmohet pyetja: përse në historinë deritanishme të studimeve të letërsisë shqipe nuk është studiuar ndonjë një vepër letrare me teorinë e rinjohjes? Mos kjo përbën vështirësinë e vetë studimit apo mungesë literature lidhur me Alteritetin në letërsinë shqipe? Kjo mungesë është në kontrast me koherencën që e bën të mundur fjala *rinjohje*, brenda një njësie leksikale të vetme, në fjalor, me gjithë shumësinë e domethënies që ajo përmban në vete. Rinjohja identifikuese nënkupton sistemin normativ veprues së brendshmi të veprës letrare. Duke njohur mirë opusin letrat e Murat Isakut metoda e studimit të poezisë së tij medoemos do ishte Alteriteti, evoluta letrare, teorinë e njohjes dhe rinjohjes gjithmonë duke i bazuar në atë që thotë francezi Ricoeur³⁴.

Studimin për *Alteritetin në poezinë e Murat Isakut* nis me një analizë krahasimtare të mënyrës si është rregulluar vetë polisemia e fjalës “*reconnaissance*”, brenda dy përmbledhjeve të tij, të parës dhe të fundit. Ky pozicionim vlerash, zgjedhesh strategjike të përfshirjes dhe përjashtimit, të identitetit dhe alteritetit (shih Paul Ricoeur). Përpykja ime është të gjejë, brenda derivimeve semantike të kësaj fjale, një “*polisemi të rregulluar*”, që në poezi është mund të jenë figurat stilistike. Në poezinë “*Prralla e kuqe*” (shih “*Zani i Malit*” f.10), Murat përdor fjalë si; *prallë, nanë, truell, nemun, prue, ngranë, rangall, bistekë, ortek, kreshta, kërhi, marshallën, shtonës, rrahun, morrizat, trina, lëmishite, andrra, cimaq*, etj., të cilat për ta painformuarit për të folmen e Gajres që është një e folme gegërishte interesante, këto fjalë duken të pakuptimta. Murat Isaku gjurmoi fjalë *plaka e të harrueme*, siç do thoshte Pjetër Bogdani për të krijuar Kështjellën e tij artistike. Në fjalë të rralla, që përdoren në trevat tona, hijeshoi mrekullisht poezinë e tij. Murat Isaku posedon zejen e shndërrimit të fjalës popullore, arkaike, nga konstruktimi dialektor në atë figurative në raport më ligjet e estetikës dhe duke mbajtur të paprekur indin e poezisë së pastër popullore. Qartësia në poezinë e tij është ajo që shpreh vërtetësinë për të cilën s’jemi të vetëdijshëm se ekziston deri në momentin e zbulimit, njohjes së imazhit të saj poetik. Ky ndryshim, evoluim, metamorfozë vargu shihet në poezinë *Përfitim i një ëndrre* ai shkruan:

“*Kur n’qepallë t’digjet një fill mendimi- ti bëhesh flakë
është mëkat apo pendesë-s’ di ç’ të them n’këtë çast...
vetëm një drithmë që fsheh – si zogu klithmën n’plagë
sikur dëshiron t’mbetet sall përfitim i një ëndrre të lashit*”.³⁵

Qartë shihet një “*gjuhë tjetër*”, një pjekuri krijuese, një ngritje e poezisë në nivelin estetik të dëshiruar, një elegancë vargu, një lehtësi leximi pa ngarkesa të fjalëve dialektore. Megjithatë diçka që mbetet e pathëne midis të domethënies të fjalëve, e që e bën të pamundur kalimin prej një niveli estetik në një më të lartë së pararendësi. Kësajsoj veçohen tri domethënie kryesore;

1. të kapet një objekt me mendje, duke lidhur midis tyre imazhet, perceptimet që i përkasin; të dallohet, të identifikohet, të njihet me kujtesë, gjykimi apo aksioni.
2. të pranohet, të mbahet si i vërtetë (ose si i tillë) dhe
3. të dëshmosh mirënjohje, se je mirënjohës ndaj dikujt (për diçka, një veprim).

Imazhet poetike në poezinë e Murat Isakut janë ato të vendlindjes, imazhet nga një atmosferë fshati, ruajtja e fjalës popullore dhe alternimi i saj në poezi, gjykimi dhe aksioni. Fati dhe Fatkeqësia në poezinë e tij paraqiten si nënshtrim ndaj Absolutes, pranohen si të tilla, si të parashkruara, si të vërteta. Murati është mirënjohës ndaj Miqve, ka nevojë për Njeriu-Mik, ka nevojë për të folur për letërsinë me njerëzit e letërsisë.

³⁴ Ricoeur, Paul, *The Conflict of Interpretations: Essays in Hermeneutics*, ed. Don Ihde, trans. Willis Domingo et al. Evanston: Northwestern University Press, 1974 (1969)

³⁵ Isaku, Murat, *M’i këpusin kokrrat e frymës*, Albas, Tetovë, 2007, f. 41

Në filozofinë transcendentale të Kantit³⁶, që hulumton kushtet apriori të mundësisë së njohjes objektive, Ricoeur heton mundësinë e një domethënieje filozofike të rinjohjes. Pastaj, brenda filozofisë së Bergsonit, të afërt me *psikologjinë refleksive*, që mëton të riformulojë sërish termat e konfrontimeve filozofike rreth raporteve të shpirtit me trupin, *rinjohja e kujtimeve* bëhet një problem i madh. Ndërkaq, brenda asaj pjesë të filozofisë së Hegelit, që merret me realizimin efektiv të lirisë brenda një konteksti historik e social, rinjohja (pranimi) zë vend në procesin e këtij realizimi përmes temës së *luftës për pranim*, të *kërkesës për të qenë i pranuar*.

Murat Isaku përmes poezisë synon të ndriçojë por edhe të kapërcejë shmangiet e kuptimeve që kanë dalë nga puna e përsiatjes, duke ndërtuar, në një shkallë më të lartë të kompleksitetit metaforik, një varg të domethënieve konceptuale, ku do të merrej parasysh shmangia midis domethënieve që varen nga problematika gjuhësore.

Përdorimet stilistike në poezinë e Murat Isakut mund të renditen sipas një vije që shkon prej përdorimit në trajtën aktive kah ai në trajtën pasive. Kjo përmbysje në planin gramatikal do të bartte gjurmën e një përmbysjeje me të njëjtën peshë në planin estetik. Në pikënisje të kësaj vije, rinjohja na del si akt që shpreh një pretendim, që të ushtrojë një zotërim intelektual në fushën e domethënieve, të pohimeve sinjifikative në poezi. Në polin e kundërt të kësaj vije, kërkesa për pranim, shpreh një pritje që mund të kënaqet vetëm si mirënjohje reciproke, *autor-lexues*, qoftë kjo një ëndërr e parealizueshme. Poezitë e tij janë të këndshme për një rilexim, riinterpretim e dialog kreativ. Në të gjitha poezitë e tij, rendi kronologjik i ngjarjeve poetike gërshetohet me rendin tematik.

Rinjohja si Identifikim

Për interpretimin e domethënies së parë, në drejtim të një koncepti filozofik, Ricoeur, para se t'i qaset analizës së asaj që shqitet në vatrën e mendimit kantian, kalon përmes një ri-mendimi të disa temave të mendimit të Platonit, Aristotelit dhe Descartesit, ku shtjellohet koncepti i gjykimit, si aftësi ose si ushtrim. *Rinjohja si identifikim e dallim*, supozon analizën e sajimit të konceptit të gjykimit. Të gjykosh do të thotë së pari të identifikosh diçka, ta dallosh atë nga diçka tjetër. Këtu nis të shquhet veçmas dialektika midis të njëjtës dhe tjetrit, si pjesë e dialektikës së qenies (gjithë ajo që është, vetëm nga aspekti i të qenit).

Analiza e *aftësisë së të gjykuarit* në poezinë e Muratit duket si një ligjëratë poetike që synon të vërë në pah nocionin e *identifikimit* dhe *identitetit* si domethënie të parë të rinjohjes. Poezia e tij bën pjesë në parimin e parë të metodës karteziiane: si të bëhet dallimi midis asaj që është e vërtetë nga ajo që është e pavërtetë, por edhe si të dallohet e njëjta nga tjetri, në saje të kriterit të qartësisë dhe dallueshmërisë? Aftësia e të gjykuarit mbi fenomenet e jetës ka domethënie e status tjetër atë të Antitezës. "*Vetë jeta është antitezë e vdekjes dhe përsëritje metabolike e fëmijërisë. Jeta është një fëmijëri në vazhdim, e cila duke dashur të mbetet e tillë, me kalimin e virgjërisë, ajo i kundërvihet fatit fatal të vdekjes*".

Në poezinë *Era e trollit dhe babait* ai shkruan:

"Ai ma fal tërë zemrën-si sythin mbi një remb dhe megjet e fëmijërisë m'i mbledh në një përrallë".³⁷

Poezia e tij bën inaugurimin e lidhjes së perceptimeve, përfytyrimeve, ideve dhe sintezës. Murat Isaku futet në këtë kërkimin edhe dimensionin e *kohës si koncept ontologjik* ku gjykimi supozon lidhjen përbrenda kohës.

³⁶ Kant, Emanuel, *Mbi të bukurën dhe të madhërishten*, Rilindja, 1990, f. 33

³⁷ Isaku, Murat, *POEZI I*, Klubi letrar 94, Tetovë, 2003, f. 21

Në poezi ai e redukton kohën, si formë, në relacione të njëpasnjëshmerisë dhe njëkohësisë; e rinjohja mbështetet në koncept të tillë të kohës. Megjithëkëtë, akti i poezisë, jo si operacion alkimik i fjalës, me të cilin bashkëndërtohet receptiviteti i njohjes shqisore (*sensibiliteti*) me spontanitetin e arsyes, është akt fundamental i gjykimit. Dyfishimi i njohjes, në njohje shqisore dhe arsye, lidhet me dallimin midis perspektivës transcendentale (që merret me kushtet apriori të njohjes e jo me objektet) dhe perspektivës empirike. Arti është paraqitja shqisore e idesë thoshte Hegeli.

Në poezinë e tij Murat Isaku zbulon, pikërisht në poezinë *Mendjes së Pastër*, brenda trajtimit të sintezës së *trup-shpirt*, ku rinjohja del si elementi i tretë, promovimin e parë, në rangun e konceptit të rinjohjes. Ai i kushton një vëmendje të veçantë shqyrtimeve stilistike dhe gjuhësore, ngritjen e fjalës në pedestalin e merituar, ku vlera e poezisë së tij zhvillohen pavetëdijshëm procesin e identifikimit brenda kohës. Ai nuk e merr parasysh përvojën krijuese si bazë të subjektit njohës, por faktin se ai është së pari, *një qenie e zhytur brenda botës*. Poezia *Fjalët tona* na bind në këtë konstatim.

*“Fjalët tona mish të egër zunë, or mik,
S’u muarëm vesh me veten, s’hëngrëm me një lugë...
Shtratin fare e prishëm si lumi n’mot të lig
Dhe mbetëm çelësa të humbur rrugë e pa rrugë...”*³⁸

Ta Rinjohësh Vetën

Elementet e një teorie të rinjohjes së vetes, në poezinë e Murat Isakut i gjejmë në disa poezi: *E këtyllë ishte jeta, Vazoja Antike, Mikut të vjetër, Diçka më mban gjallë, Çeli syzet poet* etj. Të kjo e fundit ai ri-konstrukton nga fragmentet e jetës së tij tërësinë ku shqiten mendime mbi frymëzimin poetike, strukturën e të vepruarit të njeriut-poet, mbi çështjen e pranimit të përgjegjësisë së fjalës, për veprimet plot çmenduri poeti, si dhe një teori implicite mbi aftësitë e *poetit Njeri*. Elemente të rinjohjes si vetë-dëshmim i poetit, në veprimet dhe veprat e tij nxjerrë në shesh praninë e kërkimeve refleksive tek poezitë që tematizojnë aktet e subjektit (të menduarit, perceptimin, imagjinatën, vullnetin, dëshirën etj). Poezitë i tij i shquan sidomos analizat e kategorive të kujtesës dhe premtimit, njëra e kthyer kah e kaluara e tjetra kah e ardhmja, si dhe dialektika midis të njëjtës dhe tjetrës, si dy vlera konstituive të identitetit personal. Një temë të veçantë ai i kushton rinjohjen e imazheve brenda kujtesës, veçmas në poezinë: *Qortimi i Vetvetes* dhe *Borxhi i fjalës*. Brenda kujtesës soditëse prej poeti ai gjen përputhjen e rinjohjes së imazheve nga e kaluara me rinjohjen e vetvetes. Analiza e *fenomenologjisë së premtimit* mund të shihet në disa poezitë; *Ti besoji vetëm shpirtit, Lutje për ty, Mos u dëshpëro*, etj, ku bart përpjekjen për t’i lidhur premtimin me besimin si trajta individuale të aftësisë poetike me format shoqërore, që mund ta bëjnë të mundur kalimin prej rinjohjes (pranimit) së vetes kah pranimi reciprok. Ai kudo shpalos shqyrtime të holla mbi raportet midis praktikave shoqërore dhe përfytyrimeve kolektive, mbi kategorinë e pranimit dhe identitetit kolektiv, si dhe mbi lidhjet midis kategorive “aftësitë” e njeriut dhe “të drejtat e tij”.

Pranimi (Rinjohja) i Ndërsjellë

Mbështetjen kryesore në elaborimin e problemeve lidhur me figurën e tretë të rinjohjes Ricoeur e gjen te koncepti hegelian *Anerkenung*³⁹. Vetja është e njëjtë me vetveten e jo me diçka tjetër, me çka kapërcehet

³⁸ Isaku, Murat, *POEZI I*, Klubi letrar ‘94, Tetovë, 2003, f. 84

³⁹ Ricoeur, Paul *Oneself as Another*, translated by Kathleen Blamey (Chicago: The University of Chicago Press, 1992) p. 29

papërcaktueshmëria e asaj “diçka” e objektit, si diçka e përgjithshme, në figurën e parë të rinjohjes, përkatësisht në procedurat e shumta të identifikimit. Ai hyn shqyrtimit të dialektikës së refleksivitetit dhe të alteritetit përmes figurës së pranimit të ndërsjellë. Edhe në shqyrtimin e temës së pranimit të ndërsjellë, ai zbaton të njëjtën metodë gjenealogjike, si në dy hulumtimet e mëparshme, duke tematizuar problemet filozofike, te mendimtarë të tjerë, që shpijnë te koncepti *Anerkenung* i Hegelit. Rikonstruktimin e kësaj teme, Murat Isaku e bën duke e paraqitur si përgjigje polemike ndaj gjendjes natyrore, të përcaktuar me frikën nga vdekja e dhunshme. Gjatë shtrirjes mediativo-filozofike në përmbledhjet “Shtara” dhe “Egjër” gjejmë motivin e vdekjes dhe motivin e pendesës. I pari, *motivi i vdekjes*, parandjenja e saj dhe qetësia stoike e pritjes:

*“Nga nja psherëtimë kemi hedhur mbi letrën e bardhë
qelb duke na mbledhur plagët për atdheun e humbur.
Sot, kur jemi larë në thinja – dita ndoshta ka ardhë
t’ju marrim në grykë e t’themi – kaq kemi mundur”*

Vërehet ndjenja njerëzore, vuajtja për një atë-dhe të humbur, motivi ekzistencial, trishtimi i moshës dhe paralajmërimi i ikjes, modestia sublime se “*kaq kemi mundur*”...

Motivi i dytë, është krejtësisht njerëzor dhe mjaft i rrallë në poezinë tonë, është ai i mëkatit dhe i pendesës.

*Ndoshta gabime kemi bërë për njëri – tjetrin në rrugë apo krah,
Kr dorën s’e kemi shtrirë, apo jemi shtirë se s’jemi parë...
Gabime të vogla janë këto për një trup me dy këmbë e dy krah
Për një shesh me aq pëllumba, për një det me aq valë⁴⁰.*

Edhe poezia *Lutje për mëkatin* jep imazhin e pendesës:

*“N’dy gjunj lutëm me psherëtimë si padasht
që kokërr mëkati të mos mbetet në mish”....⁴¹*

Anerkenung e bën të mundur konceptualizimin e lidhjes midis vetë-reflektimit dhe orientimit kah tjetri, kah *intersubjektiviteti*. Poezia e tij ka një intersubjektivitet të ndjeshëm i cili është i përhapur si një kryefjalë në gjithë poezitë e tij. Ai vë në vend të frikës nga vdekja natyrore, dëshirën për të qenë i ende i gjallë. Një ndryshim i vogël në poezinë e tij në dorëshkrim *Kisha vdekur ditën e enjte* tregon për dëshirën e madhe për të jetuar, për të provuar këtë bukuri shituese që ka jeta. *Poeti vdiq po ditën e enjte*. Ai ishte i lidhur me konceptin “*jetën etike*” brenda një kompleksi relacionesh shoqërore dhe ka për qëllim, njësoj, të rrenojë idenë e mbi gjendjen natyrore. Në përmbledhjet e tij me poezi ai trajton raportet ndër-individuele e ndër-grupore, nga aspekti i pranimit të ndërsjellë (dashuria dhe afektiviteti, të drejtat juridike dhe respekti shoqëror), sipas skemës hegeliane. Asokohe kishte njerëz që mbronin tezën se *identiteti ynë personal ndërtohet, pjesërisht, me pranimin apo mungesën e pranimit, si dhe me perceptimin e keq që kanë të tjerët për identitetin tonë*.

Interiorizimi i imazheve përbuzëse për *veten* tonë, imazhe që vijnë nga të tjerët, shkaktonin pasoja të rënda. Si temë etike e modernitetit, në dallim nga tema e nderit, lidhej me politikat e dallimit që i kundërviheshin parimit të barazisë universale (e shikuar si iluzore, ngase fsheh një politikë partikulare siç ishte rasti në Maqedoni). Ideja e luftës artikullohet përmes ndriçimit të atyre përvojave të pranimit, në historinë e njerëzimit, që nuk implikojnë dhunën dhe luftën. Murat Isaku do të gjejë mbështetje antropologjike mbi praktikatat shoqërore të kulturave, si moment i një politike të pranimit reciprok simbolik në kërkimet mbi pranimin e

⁴⁰ Isaku, Murat, *POEZI I*, Klubi letrar ‘94, Tetovë, 2003, f. 24

⁴¹ Po aty, f. 95

ndërsjellë. Është fjala për një tip të raporteve ndërnjerëzore që nuk i takojnë as rendit të këmbimit të të mirave materiale (rendit ekonomik), e as nuk janë shprehje e ndihmës altruiste (rendit etik), por shprehjeve simbolike të reciprocitetit. Kërkime mbi rinjohjen (pranimin, mirënjohjen) paraqesin si çelësin magjik që do ta zgjidhë problemin e pranimit të ndërsjellë, por vetëm si një dimension të mundshëm të relacioneve njerëzore, që janë të ngarkuara, vazhdimisht, me dhunën dhe mohimin e tjetrit.

Përfundimi

Ky hulumtim kishte për qëllim të vijëzohet, shkurtazi, disa anë të projektit të Ricoeur-it për nismën e problematizimit të mundësisë së një teorie mbi rinjohjen (pranimin, mirënjohjen) në poezinë e Murat Isakut. Ky qëllim ushqehet me shpresën se ai mund të cytë këshërinë për ta lexuar poezinë e tij përmes kësaj teorie. Si vepër e mirëfilltë letrare, ajo ndriçon dallimin e kërkimit mendor artistik dhe filozofik. Dallimi që bën të mundur të hetohet, përmes veprave të tilla, mëvetësia e metodës së të menduarit filozofik, e shtruarjes dhe trajtimit të pyetjeve, që nuk u përkasin disiplinave shkencore.

References

1. Agim, Vinca, Aspekte të kritikës sonë, Rilindja, Prishtinë.
2. Agron, Tufa, Janusi i Qindfytyrshëm, Prokultura, Tetovë, 2004.
3. Alfred, Uçi, Estetika, jeta, arti, botim i dytë, SHBLP, Tiranë, 1973.
4. Alfred, Uçi, Probleme të estetikës, Tiranë, 1976.
5. Ali, Aliu, Vepra të zgjedhura, I, II, III, Serembe, Shkup, 2004.
6. Isaku, Murat, M'i këpusin kokrrat e frymës, Albas, Tetovë, 2007.
7. Isaku, Murat, POEZI 1, Klubi letrar 94, Tetovë, 2003.
8. Kant, Emanuel, Mbi të bukurën dhe të madhërishten, Rilindja, 1990.
9. Northrop, Fraj, Anatomija kritike, Naprijed, Zagreb, 1979. Osman, Gashi
10. Ricoeur, Paul Oneself as Another, translated by Kathleen Blamey (Chicago: The University of Chicago Press, 1992)
11. Umberto Eco, Për letërsinë, Tiranë, 2007.